



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2018

PËR

NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9374, DATË 21.4.2005, “PËR NDIHMËN SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Përfashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore

1. Përfashtohet nga përfitimi i ndihmës shtetërore, kur ka të dhëna se subjekti përfitues i ndihmës, në kuptim të këtij ligji, është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:
 - a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
 - b) Korrupsion;

- c) Mashtrim;
 - ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;
 - d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;
 - dh) Organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
 - e) Falsifikim;
 - ë) Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.
2. Përgjashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i subjektit përfitues të ndihmës, në kuptim të këtij ligji, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.
3. Me qëllim plotësimin e kushteve për të përfituar ndihmën shtetërore, subjekti përfitues i ndihmës duhet të paraqesë vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 2 e 3, të këtij neni.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI